VENDIM
Nr. 4, datë 17.1.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË "KESH" SHA, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "d", nenit 5, pika 1, germa "d" dhe neneve 10, pika 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.1.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "KESH" sh.a., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "KESH" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 769 prot., datë 7.12.2018, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
- Në aplikimin e KESH sh.a. është konstatuar mungesë dokumentacioni, dhe ERE me shkresën nr. 769/1 prot., datë 17.12.2018, drejtuar KESH sh.a., ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit.
- Në vijim të sa më sipër, KESH sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 769/2, datë 27.12.2018, ka paraqitur në ERE dokumentacion plotësues për aplikimin e tij.
- Aplikimi i shoqërisë "KESH" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:
- Formati dhe dokumentacioni për aplikim. neni 9, pika 1. Plotësuar.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor: neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c". Plotësuar;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal neni 9, pika 3. Plotësuar.
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike: neni 9, pika 4.7, germat "a", "b", "c", "d". Plotësuar.
- Neni 9, pika 4.7.1, germat "a", "b", "c". Plotësuar.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa "d" (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), germën "e" (struktura e ndërtimit të shoqërisë, lista e personelit sipas profilit (në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca); nenin 9, pika 4.7, germa "e" (Sistemi IT); germa "f" (lista e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës), do t'i kërkohet shoqërisë KESH sh.a., plotësimi brenda afateve të përcaktuara në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "KESH" sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti